



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 4 mars 2024

Z. Gazmend Hoxha, drejtor i përgjithshëm
Policia e Republikës së Kosovës
Rruga “Luan Haradinaj ” p.n.
10 000 Prishtinë

LETËR REKOMANDIMI

A. nr.538 /2023

I nderuari z. Hoxha,

Avokati i Popullit, bazuar në nenin 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 18 shtator 2023 pranoi ankesë nga Andrija dhe Mikajllo Miciq (origj. Andrija dhe Mihajlo Micić) nga Graçanica, si dhe nga OJQ “Casa” nga Maqedonia e Veriut, përkitazi me pretendimin se Policia e Republikës së Kosovës nuk i ka respektuar dispozitat e Ligjit nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve.

Bazuar në pohimet e ankuesit Mihajlo Miciq, vërehet se Policia e Kosovës i ka shqiptuar gjobë dhe ka komunikuar me të vetëm në gjuhën shqipe, gjuhë që ankuesi nuk e ka kuptuar.

Lidhur me këtë çështje, më 10 tetor 2023 përfaqësuesja e Avokatit të Popullit kontaktoi përfaqësuesit e Policisë së Kosovës dhe kërkoi informata lidhur me çështjen e ankuesit.

Më 27 dhjetor 2023, përfaqësuesit e Policisë së Kosovës kthyen përgjigje dhe e njoftuan përfaqësuesen e Avokatit të Popullit se në çështjen e ankuesit janë shqiptuar dy gjoba kundërvajtëse: njëra gjobë në gjuhën serbe, të cilën e ka përpiluar një zyrtarë policore e komunitetit serb, dhe gjoba tjetër është përpiluar në gjuhën shqipe, nga zyrtari policor i komunitetit shqiptar.

Përkitazi me këtë çështje, Avokati i Popullit analizoi Ligjin nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve dhe vërejt:

Neni 1 [Dispozitat e Përgjithshme], paragrafi 1, nënparagrafët 1 dhe 2, përcaktojnë:

“1.1. Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë:

- i. Përdorimin e gjuhëve zyrtare, si dhe të gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, në institucionet e Kosovës, në ndërmarrje dhe organizata të tjera që realizojnë funksione dhe shërbime publike;

ii. Status të barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë, të drejta të barabarta sa i përket përdorimit të tyre në të gjitha institucionet e Kosovës.”

Neni 2, paragrafët 1 dhe 2, përcaktojnë:

“2.1. Gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës.

2.2. Të gjithë personat kanë të drejta të barabarta në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucionet e Kosovës.”

Neni 4 [Përdorimi i gjuhëve në institucionet qendrore], paragrafët 1 dhe 2, përcaktojnë:

“4.1. Në institucionet qendrore të Kosovës zbatohet barazia e gjuhëve zyrtare.

4.2. Çdo person ka të drejtë të komunikojë dhe të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga institucionet qendrore të Kosovës në cilëndo gjuhë zyrtare. Të gjitha institucionet qendrore kanë për detyrë të sigurojnë që çdo person mund të komunikojë dhe mund të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga organet dhe institucionet e tyre në cilëndo gjuhë zyrtare.”

Avokati i Popullit, duke pasur parasysh rrethanat e theksuara më sipër, vlerëson se e drejta e përdorimit të gjuhëve zyrtare, përveçqë është e përcaktuar me nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është e përcaktuar edhe me dispozitat e Ligjit nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve.

Sipas këtyre përcaktimeve, Avokati i Popullit konsideron se është obligim kushtetues dhe ligjor i secilit institucion në Republikën e Kosovës që gjatë ushtrimit të mandatit dhe të kompetencave të tyre ta ketë parasysh obligimin e përdorimit të gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës.

Lidhur me çështjen në fjalë, Avokati i Popullit thekson se Policia e Republikës së Kosovës gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre është e obliguar t'i përdorë gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës, duke u referuar në dispozitat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

Avokati i Popullit, duke pasur parasysh rrethanat e theksuara më sipër, në bazë të nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 16, paragrafi 15, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, si dhe bazuar në analizën ligjore të mësipërme, me qëllim të promovimit të barazisë në drejtim të përdorimit të gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës, i

REKOMANDON

Polici së Republikës së Kosovës:

- *Gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ta kenë parasysh obligimin ligjor për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës, pa dallim, të përcaktuar me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me Ligjin nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr.

05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.*”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

